



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri:** KSC-BC-2020-07  
*Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt*

**Vendos:** Gjykatësi i Vetëm  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Parashtrues:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 14 tetor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** *Publike*

---

**Version i redaktuar publik i**

**‘Raport i korigjuar mbi arrestimin dhe transferimin e Nasim Haradinajt në objektin e paraburgimit’, dosja KSC-BC- 2020-07/F00026/COR me datë 28 shtator 2020**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtësi për Hysni Gucatin**

Xhonatan Elistan Ris

**Mbrojtësi kujdestar për**

**Nasim Haradinajn**

Bastian Martens

1. Administratorja në vijim i raporton Gjykatësit të Vetëm mbi arrestimin dhe transferimin e z. Nasim Haradinaj ('z. Haradinaj') në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (objekti i paraburgimit) në Holandë ('shteti pritës').
2. Ky raport dorëzohet në pajtim me vendimin rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* mbi kërkesën për fletarrestime dhe urdhra transferimi (Vendimi)<sup>1</sup>, së bashku me një shtojcë që përmban material mbështetës.<sup>2</sup> Në pajtim me Vendimin, Administratorja dorëzoi më parë një raport paraprak, në pritje të marrjes së informacioneve shtesë që lidhen me të.<sup>3</sup>

## I. ARRESTIMI

1. Arrestimi i z. Haradinaj u krye nga punonjës të sigurisë operative të ZPS-së, me mbështetje logjistike të policisë së EULEX-it dhe të policisë së Kosovës.
2. Para kryerjes së arrestimit, punonjësit e ZPS-së dhe përkthyesi morën rezultatet e analizës për koronavirusin e ri ('KOVID-19'), që ishin negative. Punonjësit e sigurisë të ZPS-së dhe përkthyesi mbajtën maska gjatë gjithë arrestimit dhe transferimit.
3. Në orën 16:29 të 25 shtatorit 2020, punonjësit e ZPS-së arrestuan z. Haradinaj në rrugën Justiniani, në lagjen Pejton të Prishtinës, Kosovë. Z. Haradinaj ishte identifikuar nga punonjësit e ZPS-së si udhëtari në ulësen e përparme të një taksie që po largohej nga mjediset e Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së. Punonjësit e ZPS-së u vunë në ndjekje të taksisë [REDAKTUAR]. Nga mënyra e vozitjes së taksisë, ishte e qartë që z. Haradinaj e kishte parë automjetin [REDAKTUAR] në të cilin po udhëtonin punonjësit e ZPS-së dhe po përpiquej t'u shmangej atyre. Për shembull, me gjithë ngadalësinë e trafikut, taksia ndërroi disa herë korsi dhe, në një moment, dha sinjal për kthim në të majtë, por pastaj vazhdoi drejt në një udhëkryq. Kur u kthye për të hyrë në rrugën Justiniani, taksia u detyrua të ndalonte në trafik. Kur ndaloi taksia,

---

<sup>1</sup> *Shih* Vendim mbi kërkesën për fletarrestime dhe urdhra transferimi, KSC-BC-2018-01/F00128, 24 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 35; Urdhër për dosje të re për çështjen gjyqësore, KSC-BC-2020-07/F0001; *shih gjithashtu* rregullën 14 të Rregullores së Paraburgimit.

<sup>2</sup> Shtojca 1, Dosja e arrestim-transferimit, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>3</sup> Raport paraprak mbi arrestimin dhe transferimin e Nasim Haradinajt në pajtim me vendimin KSC-BC-2018-01/F00138, 26 shtator 2020.

z. Haradinaj doli nga automjeti dhe u orvat t'u ikte me vrap punonjësve të ZPS-së. Punonjësit e ZPS-së e arritën shpejt z. Haradinaj dhe e ndaluan menjëherë. Në kohën dhe vendin e arrestimit nuk u përdor forcë fizike apo masa shtrënguese.

4. Në kohën e arrestimit, punonjësi i ZPS-së që kreu arrestimin identifikoi veten, konfirmoi identitetin e z. Haradinaj dhe e informoi atë se ishte lëshuar një fletarrestim kundër tij. Komunikimi ndërmjet oficerit arrestues dhe z. Haradinaj u krye në gjuhën suedeze. Fare pak kohë pasi z. Haradinaj u ndalua së pari nga punonjësit e ZPS-së, filloi të mblidhej një turmë njerëzish, shumë prej të cilëve po e filmonin ngjarjen me telefona mobilë dhe bënë fotografi. Z. Haradinaj fliste me zë të lartë dhe në mënyrë demonstrative, sidomos kur komunikonte në gjuhën shqipe me kalimtarët që kishin ndaluar.

5. Z. Haradinaj deklaroi se e kundërshtonte arrestimin nga ZPS-ja sepse nuk e njeh gjykatën dhe kërkoi me këmbëngulje praninë e policisë së Kosovës. Punonjësit e ZPS-së siguruan hapësirën rreth z. Haradinaj, parandaluan përshkallëzimin e situatës, dhe organizuan ardhjen e punonjësve të Policisë së Kosovës në vendin e ngjarjes. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. Oficeri arrestues gjithashtu e informoi z. Haradinaj se nuk ishte i detyruar të fliste më tej me ekipin arrestues deri sa të ishte i pranishëm një përkthyes zyrtar.

6. Brenda pak minutash mbërritën tri njësite të Policisë së Kosovës. [REDAKTUAR].

7. Automjetet e Policisë së Kosovës mandej ndoqën [REDAKTUAR] për në objektin për transferim të sigurt të Zyrës Administrative në Prishtinë, ku mbërritën afërsisht në orën 16:54.<sup>4</sup> Me të mbërritur aty, z. Haradinaj deklaroi se i ishte plotësuar dëshira që të transportohej nga Policia e Kosovës dhe tani do t'i zbatonte urdhrat e ekipit arrestues.

8. Ndërkohë që pritej ardhja e përkthyesit, zotit Haradinaj iu dhanë kopje të fletarrestimit në gjuhët angleze dhe shqipe. Përkthyesi mbërriti në objektin e Zyrës

---

<sup>4</sup> Shtojca 1, Procesverbal i mbajtjes në ruajtje (ZPS).

Administrative për transferim të sigurt në orën 17:21, dhe pas kësaj të gjitha komunikimet u bënë në gjuhën angleze, të përkthyer në shqipe nga përkthyesi.<sup>5</sup> [REDAKTUAR].

9. Në orën 17:30, një punonjës i ZPS-së përsëriti informacionin që ishte dhënë në kohën e arrestimit dhe dy punonjës të tjerë të ZPS-së kryen një kontroll sigurie pa urdhër kontrolli të z. Haradinaj dhe i morën atij sendet personale të cilat i inventarizuan dhe i vendosën në një qese provash të vulosur me numër regjistrimi G128852.<sup>6</sup>

10. Në orën 17:54, një punonjës i ZPS-së i dorëzoi z. Haradinaj kopje të legalizuara të fletarrestimit<sup>7</sup> dhe të urdhrit të transferimit<sup>8</sup> në gjuhët angleze dhe shqipe.<sup>9</sup>

11. Në orën 17:55, një punonjës i ZPS-së, në prani të një punonjësi tjetër të ZPS-së, e informoi z. Haradinaj për të drejtat e tij në gjuhën angleze, të cilat iu përkthyen në shqipe nga përkthyesi.<sup>10</sup> Punonjësi i ZPS-së, ndër të tjera, e informoi z. Haradinaj se ai ka: të drejtën e përfaqësimit juridik nga një mbrojtës i specializuar i zgjedhur prej tij dhe që t'i caktohet mbrojtës i specializuar pa pagesë nëse nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar mbrojtjen; të drejtën që ai vetë apo dikush tjetër të njoftojë për arrestimin një anëtar të familjes apo një person tjetër të përshtatshëm të zgjedhur prej tij; dhe të drejtën për të heshtur dhe se çfarëdo deklarate e tij do të regjistrohet dhe mund të përdore si provë. Gjithashtu, punonjësi i ZPS-së i dha z. Haradinaj një kopje në letër të neneve 21 and 41(4) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar në gjuhët angleze dhe shqipe.<sup>11</sup> Z. Haradinaj nënshkroi konfirmimin se i ishte dhënë informacion për të drejtat e tij.<sup>12</sup>

---

<sup>5</sup> Shtojca 1, Procesverbal i mbajtjes në ruajtje (ZPS).

<sup>6</sup> Shtojca 1, Transferimi në ruajtje (ZPS-Zyra Administrative).

<sup>7</sup> Version i korrigjuar i fletarrestimit për Nasim Haradinajn, KSC-BC-2018-01/F00128/A03/COR, 24 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>8</sup> Urdhër për transferim në objektin e parburgimit të Dhomave të Specializuara, KSC-BD-2018-01/F00128/A04, 24 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>9</sup> Shtojca 1, Fletëdorëzim (i urdhrit për fletarrestim dhe transferim).

<sup>10</sup> Shtojca 1, Informacioni për të drejtat.

<sup>11</sup> Shtojca 1, Procesverbal i mbajtjes në ruajtje (ZPS).

<sup>12</sup> Shtojca 1, Informacioni për të drejtat.

12. Në orën 18:13, zotit Haradinaj iu dha një listë e mbrojtësve të specializuar të disponueshëm, [REDAKTUAR]. Në orën 18:23, zotit Haradinaj iu dha një telefon [REDAKTUAR].<sup>13</sup> Pas kësaj, në orën 19:09, një punonjës i ZPS-së i dorëzoi [REDAKTUAR] një letër nga shefi i Zyrës së Mbrojtjes në lidhje me arrestimin dhe transferimin e z. Haradinaj, si edhe informacion lidhur me të drejtën për të pasur mbrojtës dhe informacion lidhur me kontaktimin e z. Haradinaj në objektin e paraburgimit.<sup>14</sup>

13. Në orën 22:10, z. Haradinaj u informua se do ta kalonte natën në objektin për transferim të sigurt të Zyrës Administrative [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. Në orën 22:20, punonjësit e ZPS-së i dhanë z. Haradinaj shtroja e mbuloja të pastra dhe ujë dhe në vijim e mbikëqyrën atë gjatë natës.<sup>15</sup>

14. Në orën 10:49 të datës 26 shtator 2020, zotit Haradinaj iu shërbye mëngjesi [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].<sup>16</sup> [REDAKTUAR].<sup>17</sup>

15. Në orën 12:40, punonjësit e ZPS-së e transferuan z. Haradinaj me veturë në vendin e transferimit në ruajtje [REDAKTUAR].<sup>18</sup> Procedura e transferimit në ruajtje filloi në orën 13:15.<sup>19</sup>

## II. TRANSFERIMI

16. Transferimi i z. Haradinaj në ruajtje të Dhomave të Specializuara u zbatua nga koordinatori i sigurisë së misionit (KSM) i Zyrës Administrative, i shoqëruar nga ekipi përcjellës i Zyrës Administrative. Evidenca e transportimit, që përmban hollësitë e procesit të transferimit, u përgatit në kohë reale nga koordinatori i sigurisë së misionit dhe origjinali i saj i shkruar me dorë i është bashkëlidhur këtij raporti, së bashku me

---

<sup>13</sup> Shtojca 1, Procesverbal i mbajtjes në ruajtje (ZPS).

<sup>14</sup> Shtojca 1, Procesverbal i mbajtjes në ruajtje (ZPS); Shtojca 1, Letër e shefit të Zyrës së Mbrojtjes, KSC/REG/DEF/0128, 25 shtator 2020.

<sup>15</sup> Shtojca 1, Procesverbal i mbajtjes në ruajtje (ZPS).

<sup>16</sup> Shtojca 1, Procesverbal i mbajtjes në ruajtje (ZPS).

<sup>17</sup> Shtojca 1, [REDAKTUAR].

<sup>18</sup> Shtojca 1, Procesverbal i mbajtjes në ruajtje (ZPS).

<sup>19</sup> Shtojca 1, Procesverbal i mbajtjes në ruajtje (ZPS); Shtojca 1, Evidencë e transportimit të të paraburgosurit.

një kopje të transkriptuar të saj, të përgatitur dhe vërtetuar nga koordinatori i sigurisë së misionit.<sup>20</sup>

17. Përpara transferimit, koordinatori i sigurisë së misionit dhe anëtarët e ekipit përcjellës morën rezultatet negative të analizës së KOVID-19.<sup>21</sup> Gjatë gjithë transferimit, koordinatori i sigurisë së misionit dhe ekipi përcjellës mbajtën maska në fytyrë dhe siguruan që zotit Haradinaj t'i jepej maskë dhe solucion për dezinfektimin e duarve.<sup>22</sup> Gjithashtu, edhe mjetet shtrënguese dhe sipërfaqet e prekshme u pastruan para transferimit.<sup>23</sup>

18. Në orën 13:38, [REDAKTUAR], koordinatori i sigurisë së misionit i shpjegoi z. Haradinaj procesin e transferimit. [REDAKTUAR].<sup>24</sup>

19. Në orën 13:45, koordinatori i sigurisë së misionit nënshkroi transferimin në ruajtje të z. Haradinaj nga ZPS-ja në Dhomat e Specializuara. Koordinatori i sigurisë së misionit gjithashtu nënshkroi për transferimin e një qeseje të vulosur me prova, me numër regjistrimi G128852, si edhe një qese të dytë të vulosur me sende personale, dokumente, [REDAKTUAR] me numër regjistrimi L00650715.<sup>25</sup>

20. Në orën 14:12, avioni u nis [REDAKTUAR]. Gjatë tranzitit zotit Haradinaj iu ofrua diçka për të ngrënë dhe për të pirë.<sup>26</sup>

21. Në orën 15:10 dhe në orën 15:11, Administratorja njoftoi ambasadën e Republikës së Kosovës në Hagë dhe ambasadën e Suedisë në Hagë se z. Haradinaj po transferohej në objektin e paraburgimit në shtetin pritës, në përputhje me fletarrestimin dhe urdhrin e transferimit.<sup>27</sup>

22. Në orën 16:30, avioni u ul [REDAKTUAR].

---

<sup>20</sup> Shtojca 1, Evidencë e transportimit të të paraburgosurit.

<sup>21</sup> Shtojca 1, Listë kontrolli lidhur me Kovid-19 (Transferimi).

<sup>22</sup> Shtojca 1, Listë kontrolli lidhur me Kovid-19 (Transferimi).

<sup>23</sup> Shtojca 1, Listë kontrolli lidhur me Kovid-19 (Transferimi).

<sup>24</sup> Shtojca 1, Evidencë e transportimit të të paraburgosurit; Shtojca 1, fotografi (në vendin e transferimit).

<sup>25</sup> Shtojca 1, Transferimi në ruajtje (ZPS-Zyra Administrative).

<sup>26</sup> Shtojca 1, Evidencë e transportimit të të paraburgosurit.

<sup>27</sup> Nota Verbale me nr. NV2020/0031 dhe NV2020/0031, 26 shtator 2020.

23. Në orën 16:40, koordinatori i sigurisë së misionit e shoqëroi z. Haradinaj [REDAKTUAR] dhe e transferoi atë në ruajtje të Shërbimit të Transportit dhe Mbështetjes të Holandës ('DV&O'), së bashku me qesen e vulosur L00650715.<sup>28</sup>
24. Qesja e vulosur me prova, me numër regjistrimi G128852, u mbajt nga koordinatori i sigurisë së misionit dhe iu dorëzua drejtpërsëdrejti Njesisë së Paraburgimit ('NJP') të Zyrës Administrative në orën 17:05.<sup>29</sup>
25. Në orën 17:20, Shërbimi i Transportit dhe Mbështetjes i Holandës e transferoi z. Haradinaj në ruajtje të NJP-së, për pranim në objektin e paraburgimit.<sup>30</sup> Shërbimi i Transportit dhe Mbështetjes i Holandës i raportoi koordinatorit të sigurisë së misionit se gjatë transportit nuk kishte pasur asnjë incident.
26. Shefi i paraburgimit njoftoi pa vonesë Administratoren, e cila menjëherë njoftoi Gjykatësin e Vetëm<sup>31</sup> dhe shefin e Zyrës së Mbrojtjes në përputhje me rregullën 10 të Rregullores së Paraburgimit, si edhe Kryetaren dhe Avokatin e Popullit. Administratorja njoftoi gjithashtu edhe Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.<sup>32</sup>
27. Pas mbërritjes së z. Haradinaj në objektin e paraburgimit në shtetin pritës, procedurat e pranimit të tij u kryen në përputhje me Rregulloren e Paraburgimit.<sup>33</sup>
28. [REDAKTUAR].
29. Shefi i paraburgimit kreu intervistën e mbërritjes me z. Haradinaj, me ndihmën e një përkthyesi. Gjatë intervistës së mbërritjes, zotit Haradinaj iu dhanë informacionet dhe dokumentet e përmendura në rregullën 12.3 të Rregullores së Paraburgimit. Shefi i paraburgimit konfirmoi se z. Haradinaj kishte marrë kopje të legalizuara të fletarrestimit dhe të urdhrit të transferimit në gjuhët angleze dhe shqipe.

---

<sup>28</sup> Shtojca 1, Evidencë e transportimit të të paraburgosurit; Shtojca 1, Kërkesë për transportimin nga aeroporti dhe transferimin e personit të paraburgosur.

<sup>29</sup> Shtojca 1, Transferimi në ruajtje (ZPS-Zyra Administrative).

<sup>30</sup> Shtojca 1, Kërkesë për transportimin nga aeroporti dhe transferimin e personit të paraburgosur.

<sup>31</sup> *Shih* Njoftim i pranimit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, KSC-BC-2018-01/F00137, 26 shtator 2020.

<sup>32</sup> *Shih* Marrëveshje ndërmjet Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq lidhur me vizitat tek personat që u është hequr liria në përputhje me juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 28 janar 2019, para. 12(2).

<sup>33</sup> KSC-BC-2018-01/F00137A01.



30. Gjatë intervistës së mbërritjes, zotit Haradinaj iu dha informacioni i kontaktit për zyrat konsullore [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

31. Nga ora 18:30 deri në 19:05, shefi i Zyrës së Mbrojtjes foli me z. Haradinaj përmes videolidhjes, si edhe me ndihmën e një përkthyesi. Shefi i Zyrës së Mbrojtjes i dha z. Haradinaj informacion dhe dokumente lidhur me disponueshmërinë e përfaqësimit juridik në bazë të rregullës 12.2 të Rregullores së Paraburgimit dhe konfirmoi se zyra e administrimit e NJP-së i kishte dhënë z. Haradinaj të gjitha dokumentet përkatëse lidhur me ndihmën juridike, si dhe një letër, në anglishte dhe në shqipe, ku shpjegohej e drejta e tij për të pasur mbrojtës.<sup>34</sup>

32. Shefi i Zyrës së Mbrojtjes gjithashtu e informoi z. Haradinaj se, nëse dëshironte të këshillohej me mbrojtësin kujdestar në atë kohë, Administratorja e kishte emëruar mbrojtësin kujdestar për të. [REDAKTUAR].

33. [REDAKTUAR].

34. [REDAKTUAR].

35. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

### III. KLASIFIKIMI

36. Ky raport dorëzohet si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* në pajtim me klasifikimin e KSC-BC-2018-01/F00128, së bashku me një shtojcë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

37. Administratorja nuk ka kundërshtim që parashtrimi themelor të riklasifikohet si publik, në varësi të ndonjë kundërshtimi që mund të ketë ZPS-ja; megjithatë, me gjasë do të jetë e nevojshme që nga çdo version publik i parashtrimit të hiqen disa të dhëna konfidenciale [REDAKTUAR] dhe të dhëna të tjera personale të z. Haradinaj.

38. Shtojca nuk duhet të riklasifikohet deri sa të redaktohen emrat dhe inicialet e punonjësve të ZPS-së dhe të punonjësve të Zyrës Administrative, për shkak se bëhet fjalë për interesa të rëndësishme, ndër të cilat privatësia dhe siguria e këtyre individëve, shumë prej të cilëve janë të përfshirë në veprimtari hetimore aktuale dhe

---

<sup>34</sup> Shtojca 1, Letër e shefit të Zyrës së Mbrojtjes, KSC/REG/DEF/0125, 25 shtator 2020.



do të përfshihen në veprimtari hetimore në të ardhmen, si edhe në operacione arrestimi dhe transferimi, nëse do të ketë të tilla. Nëse Gjykatësi i Vetëm do të konsiderojë mundësinë e riklasifikimit të Shtojcës, Administratorja kërkon t'i jepet mundësia që t'i dorëzojë Gjykatësit të Vetëm një version publik të redaktuar të Shtojcës, ose t'i paraqesë Gjykatësit të Vetëm komente lidhur me versionin e redaktuar të propozuar.

**Numri i fjalëve në origjinal: 2097**

\_\_\_\_\_/nënshkrimi/

**Dr. Fidelma Donlon**

**Administratore**

E hënë, 28 shtator 2020

Në Hagë, Holandë

*Shënim shpjegues:* Në paragrafët 11, 16, 17, dhe 23ëstë korrigjuar emri “z. Haradinaj”.